



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Gjakovë/Osnovno Tužilaštvo Gjakova/Gjakova Basic Prosecution

AD.nr.03/2024

Dt.03.10.2024

Gj a k o v ë

Prokuroria Themelore në Gjakovë/Kryeprokurori [REDAKTUAR], duke vendosur lidhur me çështjen disiplinore të iniciuar pas pranimit të informatave nga [REDAKTUAR], ndaj prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë [REDAKTUAR], konform nenit 9 par.1 pika.1.5 dhe par.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 par.3 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, merr këtë:

V E N D I M

KONSTATOHET se nuk ka bazë për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorit [REDAKTUAR], pasi që nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Në cilësi të autoritetit kompetent nga [REDAKTUAR], kam pranuar e-mail zyrtar ku ndër tjera është cekur se është mbyllur pjesërisht rasti PPN.nr. [REDAKTUAR], sa i përket pretendimeve për përfshirjen e prokurorit [REDAKTUAR], në vepra penale të korrupsionit të paraqitura në Propozimin për Delegim të lëndës në kompetencë të Prokurorisë Themelore në [REDAKTUAR] PP.I.nr. [REDAKTUAR], dt. 12.03.2024, për shkak se nuk është vërtetuar dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Arsyeja e këtij njoftimi nga [REDAKTUAR] ka qenë që në cilësi të Autoritetit Kompetent të vlerësoj nëse në veprimet e të paraqiturit [REDAKTUAR], të cilit i referohet Propozimi i Prokurorisë Themelore në [REDAKTUAR] PP.I.nr. [REDAKTUAR], dt.12.03.2024, përmbushen ose jo elementet e përgjegjësisë disiplinore sipas Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë.

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Duke marr për bazë njoftimin nga [REDAKTUAR] dhe faktin se materialet në lidhje me këtë çështje gjenden në Prokurorinë Themelore [REDAKTUAR], kam kërkuar që të pajisem me materialet që ndërlidhen me prokurorin [REDAKTUAR]. Më datë 13.09.2024 nga prokurori i çështjes në Prokurorinë Themelore [REDAKTUAR], kam pranuar njoftimin së bashku me komunikimin e printuar [REDAKTUAR], i cili ka rezultuar nga ekzaminimi i telefonit mobil të të pandehurit [REDAKTUAR].

Po ashtu nga prokurori [REDAKTUAR], kam pranuar njoftimin në lidhje me çështjen konkrete.

Të gjeturat e autoritetit kompetent:

Nga transkriptet e siguruara rezulton se i pandehuri [REDAKTUAR], komunikon me personin me emrin [REDAKTUAR] ku një herë ceket emri i një të dyshuar [REDAKTUAR] më pas [REDAKTUAR], që dyshohet të ketë qenë palë në trajtim nga ana e prokurorit [REDAKTUAR]. Nga përgjigja e prokurorit vërtetohet se i njëjti fare nuk njihet me të pandehurin [REDAKTUAR] dhe asnjëherë në asnjë formë, direkte apo indirekte nuk ka pasur komunikime me të.

Prokurori [REDAKTUAR] në njoftimin e tij ndër tjera ka cekur se pas interesimit të mediave që ka të bëjë me një person i cili quhet [REDAKTUAR] ka shikuar në sistemin SMIL dhe ka rrjedhë se një person me emër të tillë nuk figuron në sistem, ndërsa nëse është fjala për lëndën me nr. PP/II.nr. [REDAKTUAR] për të cilën është interesuar gazetarja [REDAKTUAR] pas analizimit të sajë rrjedhë se kjo lëndë ka të bëjë me të dyshuarin [REDAKTUAR] i cili është dyshuar lidhur me veprën penale nga neni 366 të KPRK-së. Ky rast është duke u proceduar për faktin se nga lënda penale PP/II.nr. [REDAKTUAR] e që është proceduar nga DKR e kësaj prokurorie lidhur me veprën penale 267 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe nga raporti i [REDAKTUAR] të datës 05.05.2022 i siguruar po sipas kësaj lënde janë siguruar disa fotografi ku i dyshuari [REDAKTUAR] shihet me një armë [REDAKTUAR], ashtu që pas marrjes së kësaj informate nga ana e jonë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, ashtu që është urdhëruar kontrolli i shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të dyshuarit, nga i cili kontroll nuk është gjet asgjë e dyshimtë, andaj edhe rasti ka vazhduar në procedure të rregullt.

Duke vlerësuar të lartcekurat në rastin konkret vërtetohet se prokurori [REDAKTUAR], nuk ka pasur asnjë komunikim të vetëm me të pandehurin [REDAKTUAR] apo me ndonjë person tjetër rreth lëndës dhe nuk është provuar që i njëjti të ketë ndërmarrë çfarëdo veprimi në favor të palës lidhur me çështjen apo personin që ceket në transkriptet nga i pandehuri [REDAKTUAR] dhe se nuk ka vepruar në kundërshtim me kodin etik, apo me vendimet dhe udhëzimet e ligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit, gjithashtu nuk vërtetohet të jetë përfshirë në sjellje, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit.

Po ashtu në kuptim të nenit 9 par.5 dhe 6 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, që ka të bëjë me obligimin e njoftimit të palës ankuese, konstatojmë se në këtë rast nuk kemi ndonjë palë ankuese dhe se shkeljet e pretenduara disiplinore kanë rrjedhë nga transkriptet e lëndës penale të trajtuar nga Prokuroria Themelore në [REDAKTUAR].

Për arsyet e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të vendimit.

T'i dorëzohet :

[REDAKTUAR]
- Në mungesë të palës ankuese një kopje në shkresat e lëndës

